

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT

SEKSIONI I TRETË VENDIM

Kërkesa nr. 34926/18

GENTIANA HOXHA KUNDËR SHQIPËRISË

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 13 dhjetor 2022, si një Komitet i përbërë nga:

Georgios A. Serghides, *kryetar*,

Jolien Schukking,

Darian Pavli, *gjyqtarë*

dhe Olga Chernishova, *zëvendëssekretar i Seksionit*,

duke marrë në konsideratë:

kërkesën (nr. 34926/18) kundër Republikës së Shqipërisë depozituar pranë Gjykatës, sipas nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (“Konventa”) më 11 korrik 2018 nga një shtetase shqiptare, znj. Genita Hoxha, e cila ka lindur në vitin 1984 dhe banon në Tiranë (“kërkuesja”), e cila u përfaqësua nga z. G. Muçaj, një avokat që e ushtron profesionin në Tiranë;

vendimin për të njoftuar në lidhje me ankesën Qeverinë Shqiptare (“Qeveria”), fillimisht e përfaqësuar nga ish-agjenti i saj, z. A. Metani, dhe në vijim nga z. O. Moçka, Avokat i Përgjithshëm i Shtetit;

vërejtjet e palëve;

pasi diskutoi, vendos si më poshtë:

LËNDA E ÇËSHTJES

1. Pas ndërprerjes së kontratës së saj të punësimit me Ambasadën e Kosovës në Tiranë, kërkuesja ngriti një padi civile në Gjykatën e Rrethit Tiranë ndaj ish-punëdhënësit të saj, ku kundërshtonte shkarkimin e saj. Më 28 dhjetor 2016, Gjykata e Rrethit Tiranë e rrëzoi kundërshtimin e palës së paditur që pretendonte se mosmarrëveshja ishte jashtë juridiksionit të gjykatave shqiptare.

2. Më 6 nëntor 2016, ndryshimet në Ligjin për Gjykatën Kushtetuese hynë në fuqi, duke shkurtuar afatin për dorëzimin e një ankese kushtetuese nga dy vjet në katër muaj “pas vënies në dijeni për ndërhyrjen [me një të drejtë ose liri kushtetuese]”, dhe dispozita në lidhje me afatin e ri do të hynte në fuqi më 1 mars 2017.

3. Si pala e paditur edhe kërkuesja depozituan ankesa kundër vendimit më 28 dhjetor 2016 pranë Gjykatës së Lartë dhe procedurat pranë asaj gjykate nisën më 23 mars 2017. Gjykata e Lartë mbajti një seancë më 27 prill 2017, ku theksonte pjesën operative të vendimit të saj që rrëzonte vendimin e Gjykatës së Rrethit dhe duke vendosur se mosmarrëveshja ishte jashtë juridiksionit të Gjykatave Shqiptare. Vendimi i Gjykatës së Lartë iu dorëzua kërkueses më 18 shtator 2017.

4. Sipas kërkueses, ajo depozitoi një ankesë kushtetuese më 23 janar 2018 dhe sipas Qeverisë më 24 janar 2018. Kërkuesja pretendonte se ishte shkelur e drejta e saj për t’iu drejtuar gjykatës dhe e drejta e saj për t’iu drejtuar një gjykate të paanshme, dhe se vendimi i Gjykatës së Lartë nuk ishte arsyetuar në mënyrën e duhur, dhe se nuk ishte respektuar parimi i sigurisë juridike. Më 8 shkurt 2018, Gjykata Kushtetuese e deklaroi ankesën e kërkueses të papranueshme pasi ishte depozituar jashtë afatit katërmujor, duke e përlllogaritur periudhën nga data 27 prill 2017, datë kur Gjykata e Lartë miratoi vendimin e saj.

VLERËSIMI I GJYKATËS

5. Kërkuesi u ankua se ajo nuk mund t’i drejtohej Gjykatës Kushtetuese sepse ajo e kishte përlllogaritur afatin katërmujor për depozitim të ankesës kushtetuese nga data e miratimit të vendimit të miratuar nga Gjykata e Lartë dhe jo nga data kur ky vendim i ishte dorëzuar asaj.

6. Gjykata vëren se kërkuesja depozitoi një ankesë kushtetuese ndaj vendimit të kundërshtuar të Gjykatës së Lartë të miratuar më 27 prill 2017, që do të thotë pas datës 1 mars 2017 kur hyri në

fuqi dispozita që parashikonte një afat katërmujor për depozitimin e një ankese kushtetuese. Për këtë arsye, afati katërmujor zbatohej qartazi për çështjen e kërkesës.

7. Gjykata vëren se palët ranë dakord që vendimi i Gjykatës së Lartë iu dorëzua avokates së kërkesës më 18 shtator 2018, dhe se sipas kërkesës, ajo e dorëzoi ankesën e saj kushtetuese më 23 janar 2018. Në vijim, Gjykata vëren se edhe nëse e pranon pozicionin e kërkesës se afati katërmujor për depozitimin e ankesës kushtetuese kishte filluar të përllogaritej nga data kur asaj i ishte dorëzuar vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë, ai afat përfundonte më 18 janar 2018, që ishte e enjte dhe një ditë normale zyrtare në Shqipëri. Megjithatë, kërkesja pretendonte se ajo e kishte depozituar ankesën e saj kushtetuese të martën në vijim, 23 janar 2018. Pra, në çdo rast ajo ishte dorëzuar jashtë afatit katërmujor.

8. Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se ankesa e kërkesës për mungesën e mundësisë për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese ishte haptazi e pabazuar, pasi i mungon çdo indicje për shkeljen e së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës të parashikuar në nenin 6 të Konventës (shih, për parime të përgjithshme, *Zubac kundër Kroacisë* [DHM], nr. 40160/12, §§ 76–99, 5 prill 2018).

9. Rezulton se kjo pjesë e kërkesës duhet të rrëzohet në mbështetje të nenit 35 § 3 (a) dhe 4 të Konventës.

Për këto arsye, Gjykata, në mënyrë unanime,

E shpall kërkesën të papranueshme.

Hartuar në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më datë 26 janar 2023.

Olga Chernishova
ZËVENDËSSEKRETAR

Georgios A. Serghides
KRYETAR